

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo

UNMIK/REG/2005/16  
8 prill 2005

---

## **RREGULLORE NR. 2005/16**

### **MBI QARKULLIMIN E LIRË TË PERSONAVE BRENDA DHE JASHTË KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e administratës së përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të rregullimit të qarkullimit të personave brenda dhe jashtë Kosovës,

Shpall si vijon:

#### **KREU I: Dispozitat e përgjithshme**

##### **Neni 1** **Përkufizimet**

Në këtë Rregullore:

1.1 “Autoritet kompetent” do të thotë organi brenda Shtyllës së Policisë dhe Drejtësisë, që është përgjegjës për marrjen e vendimeve në shkallë të parë mbi kërkesat për statusin e refugjatit, si dhe të kërkesave dhe vendimeve të tjera mbi përfundimin e statusit të refugjatit;

- 1.2 “Anëtar i familjes” do të thotë bashkëshorti/ja, i afërmi i familjes në vijë të drejtpërdrejtë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllau, motra, prindi birësues ose kujdestar ligjor;
- 1.3 “Banor i përhershëm” do të thotë personi i cili i plotëson kriteret e parapara sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 të datës 17 mars 2000 mbi regjistrimin qendror civil;
- 1.4 “Personel i KFOR-it” do të thotë i tërë stafi ushtarak dhe civil i KFOR-it, të cilët posedojnë letërnjoftim të veçantë të lëshuar nga komandanti i forcave të KFOR-it apo me autorizim të tij ;
- 1.5 “Ardhje masive” do të thotë numër i konsiderueshëm i ardhjeve në Kosovë brenda një periudhe të shkurtër kohore i personave nga i njëjti shtet, të cilët janë zhvendosur nën rrethana që nënkuptojnë se personat nga këto grupe i plotësojnë kushtet për mbrojtje ndërkombëtare dhe, për të cilët, për shkak të numrit të tyre, marrja e vendimit individual për status të refugjatit në aspektin procedural nuk është praktik;
- 1.6 “Anëtar ekipi” do të thotë personi që shërben në çfarëdo cilësie në ndonjë automjet;
- 1.7 “Zyrtar” do të thotë zyrtari i policisë kufitare të UNMIK-ut i autorizuar në mënyrë të duhur;
- 1.8 “Pikë hyrëse” do të thotë vendkalim i autorizuar kufitar shtetëror apo administrativ i paraparë me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr.2003/18 të datës 30 korrik 2003, me të cilën ndryshohet Udhëzimi administrativ i UNMIK-ut nr.2001/15 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/10 për ndalimin e kalimit të paautorizuar të kufirit shtetëror/administrativ;
- 1.9 “Refugjat” do të thotë personi, i cili për shkak të frikës së bazuar nga keqtrajtimi në baza racore, fetare, të kombësisë, të anëtarësimit në një grup të caktuar shoqëror apo për shkak të mendimit të tij politik, gjendet jashtë shtetit amë dhe nuk është në gjendje apo nuk dëshiron që të përfitojë nga mbrojtja e atij shteti; ose i cili, duke mos pasur shtetësi dhe duke qenë jashtë shtetit ku më herët ka pasur qëndrim të përherëshëm, për shkak të frikës së bazuar se do të përndjeket në baza racore, fetare, të kombësisë, të anëtarësimit në një grup të caktuar shoqëror apo për shkak të mendimit të tij politik, nuk është në gjendje që të kthehet në shtetin amë apo për shkak të frikës së tillë nuk dëshiron të kthehet. Kur personi posedon më shumë se një shtetësi, “shtet i shtetësisë së tij” do të thotë çdo shtet shtetas i së cilit është ai dhe atij personi nuk do të konsiderohet se i mungon mbrojtja nga ana e shtetit ku ai është shtetas në qoftë se pa ndonjë arsye të qëndrueshme për shkak të frikës së bazuar, ai nuk ka shfrytëzuar mbrojtjen e njërit prej shteteve, shtetas i të cilit është ai.

1.10 “Mbrotjtje e përkohshme” do të thotë procedurë me karakter të jashtëzakonshëm për ofrimin e ndihmës së menjëhershme dhe të përkohshme e personave të zhvendosur me rastin e ardhjes së tyre masive ose ardhjes masive të pashmangshme nga shtetet e treta, të cilët nuk janë në gjendje që të kthehen në shtetin e tyre amë.

1.11 “Kompani transportuese” do të thotë personi apo grupi i personave të cilët transportojnë apo sigurojnë transportin e personave a të mallrave me automjet apo në mënyra të tjera;

1.12 “Dokument udhëtimi” do të thotë pasaporti i vlefshëm kombëtar ose diplomatik me afat të paskaduar, lejkalimi i Kombeve të Bashkuara, dokumenti i udhëtimit i UNMIK-ut ose ndonjë dokument tjetër ekuivalent i pranuar;

1.13 “UNMIK” do të thotë prania civile ndërkombëtare e themeluar në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit në territorin e Kosovës duke përfshirë komponentet e Policisë dhe të Drejtësisë; Administratës Civile; Ndërtimit të Institucioneve (OSBE) dhe të Rindërtimit (BE-ja);

1.14 “Personel i UNMIK-ut” do të thotë zyrtarët e Kombeve të Bashkuara, ekspertët dhe personat tjerë të caktuar për të shërbyer në njërin prej komponenteve të UNMIK-ut, të cilët posedojnë kartën e identifikimit, që dëshmon se mbajtësi është anëtar i UNMIK-ut e cila është lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm apo me autorizim të tij;

1.15 “Dokument i udhëtimit të UNMIK-ut” do të thotë dokument udhëtimi i vlefshëm me afat të paskaduar, i lëshuar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/18 të datës 29 mars 2000 mbi dokumentet e udhëtimit;

1.16 “Automjet” do të thotë çdo mjet transporti që përdoret për transportim tokësor, ujor ose ajror;

1.17 “Vizitor” do të thotë personi i cili qëndron legalisht për një periudhë të përkohshme në Kosovë, i cili nuk i përmbush kushtet e neneve 2.1, 2.2 dhe 2.3 dhe nuk bën kërkesë për status të refugjatit dhe

1.18 “Rikthim vullnetar” do të thotë kthimi i personit në shtetin e shtetësisë së tij ose të banimit të tij të përhershëm me qëllim të qëndrimit të tij të përhershëm aty.

## Neni 2

### Kategoritë e personave që hyjnë në Kosovë

2.1 Personi ka të drejtë të hyjë dhe të qëndrojë në Kosovë për kohë të pacaktuar

nëse:

- (a) Posedon dokumentin e udhëtimit të UNMIK-ut;
- (b) Posedon letërnjoftimin me të cilin mund të dëshmojë se poseduesi është banor i përhershëm i Kosovës;
- (c) Është anëtar i varur i familjës dhe është nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare (18) apo është bashkëshort/e e njërit nga personat që i takojnë njëres prej kategorive të sipërpërmendura ose
- (d) Është i autorizuar që të qëndrojë përgjithmonë në Kosovë nga autoriteti gjegjës qeveritar në pajtim me udhëzimet dhe rregullat e caktuara nga ana e Qeverisë në bashkërendim me UNMIK-un.

2.2 Nga personi i cili nuk i plotëson kushtet e parapara të nenit 2.1 nuk do të kërkohet që të sigurojë autorizimin për të hyrë dhe qëndruar në Kosovë, nëse personi i tillë posedon dokumentin e udhëtimit ose letërnjoftimin e bashkësisë shtetërore të Serbisë dhe Malit të Zi.

2.3 Nga personi që nuk i plotëson kushtet e parapara të nenit 2.1 nuk do të kërkohet që të sigurojë autorizimin për të hyrë dhe qëndruar në Kosovë nëse personi i tillë është:

- (a) Anëtar i personelit të UNMIK-ut apo të KFOR-it;
- (b) Zyrtar i Kombeve të Bashkuara ose ekspert në kuadër të Misionit të Kombeve të Bashkuara ose
- (c) Zyrtar i një organizate ndërkombëtare ndërqeveritare me zyrë të vendosur në Kosovë apo me zyrë ndërlidhëse të një qeverie të huaj në Kosovë.

2.4 Nga vizitori kërkohet që të sigurojë lejen për të hyrë dhe për të qëndruar përkohësisht në Kosovë.

2.5 Procedurat lidhur me personat të cilët detyrimisht kthehen në Kosovë mbesin jashtë fushëveprimit të kësaj Rregullorje.

## **KREU II: Leja për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm në Kosovë**

### Neni 3 Kërkesa për leje

3.1 Personi i cili kërkon leje për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm në Kosovë, lejen e tillë e kërkon nga personi zyrtar në vendkalimin kufitar të hyrjes në Kosovë.

3.2 Me kërkesë, personi mund të kërkojë leje në emër të tij dhe për çdo anëtarë shoqërues të familjes nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare (18).

3.3 Kërkesa për leje të hyrjes dhe qëndrimit të përkohshëm në Kosovë përfshin të dhënat vijuese:

- (a) Identitetin e kërkuarit;
- (b) Identitetin e çdo anëtari shoqërues të familjes për të cilët gjithashtu është bërë kërkesa;
- (c) Arsyet e kërkuarit për hyrje dhe qëndrim në Kosovë si dhe
- (d) Çfarëdo dokumenti mbështetës për të lartpërmendurit.

3.4 Kërkuari ka për detyrë të argumentojë arsyeshmërinë e hyrjes dhe të qëndrimit në Kosovë.

#### Neni 4

#### Dhënia e lejës për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm në Kosovë

Personi zyrtar i jep leje kërkuarit për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm në Kosovë në qoftë se ai është i bindur se kërkuari:

- (a) Viziton Kosovën për qëllime të pushimit apo të turizmit;
- (b) Është i regjistruar në një program studimi në Kosovë;
- (c) Është i punësuar ose ka interesim të arsyeshëm në afarizëm në Kosovë apo viziton Kosovën me qëllim të punësimit a të afarizmit;
- (d) Është anëtar i familjes së personit i cili qëndron në Kosovë në bazë të nenit 4(b) ose 4(c);
- (e) Është anëtar i familjes së personit i cili qëndron në Kosovë në bazë të neneve 2.1, 2.2 ose 2.3;
- (f) Është në kalim tranzit apo të pandërprerë për në Kosovë apo nga Kosova;

- (g) Është i ftuar në Kosovë nga një autoritet kompetent ose
- (h) I plotëson kërkesat e parapara sipas nenit 16, nenit 17.1 ose nenit 18.

Neni 5  
Refuzimi i lejes për hyrje dhe qëndrim në Kosovë

5.1 Personi zyrtar ia refuzon kërkuarit lejen për hyrje dhe qëndrim në Kosovë nëse personi zyrtar ka bazë dhe mbështetje për të besuar se kërkuari nuk i përmbush kriteret e parapara sipas nenit 4.

5.2 Pavarësisht nga neni 4, personi zyrtar mund t'ia refuzojë kërkuarit lejen nëse personi zyrtar ka arsye për të besuar se kërkuari i tillë:

- (a) Vuan nga një sëmundje serioze ngjitëse me të cilën mund ta rrezikojë shëndetin publik apo sigurinë publike, ashtu siç është konfirmuar nga ana e mjekut kompetent për shëndetin publik në Kosovë;
- (b) Angazhohet apo është i angazhuar në akte terroriste;
- (c) Ka qenë ose është anëtar i ndonjë organizate të kriminalitetit apo terrorizmit të organizuar
- (d) Angazhohet në akte të dhunës me të cilat mund të rrezikojë jetën apo sigurinë e personave në Kosovë;
- (e) Më parë është hequr apo i është mohuar leja për hyrje dhe qëndrim në Kosovë, kurse arsyet për heqjen apo mohimin e lejes akoma janë në fuqi;
- (f) Kalon nëpër Kosovë për të shkuar ilegalisht në një shtet tjetër ose
- (g) Hyn në Kosovë për të minuar qëllimet dhe parimet e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe mbrojtjen e rendit dhe të ligjshmërisë civile, mbrojtjen dhe mbështetjen e të drejtave të njeriut dhe garantimin e kthimit të sigurt dhe të papengësë të të gjithë refugjatëve e të personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë.

5.3 Personi zyrtar i cili refuzon lejen për hyrje në Kosovë ia lëshon kërkuarit vendimin me shkrim me arsyetimin i cili përfshin njoftimin mbi të drejtën për rishqyrtim të vendimit si dhe afatin kohor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim. Vendimi përmban edhe urdhrin me të cilin kërkohet që personi i tillë ta lëshojë Kosovën. Policët e UNMIK-ut e zbatojnë menjëherë urdhrin për largim nga Kosova.

## Neni 6

### Kushtet dhe rrethanat për dhënien e lejes

- 6.1 Kur personi zyrtar jep lejen për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm në Kosovë, në atë rast vulos dokumentin e udhëtimit të kërkuesit ose lëshon ndonjë vërtetim tjetër për kërkuesin me të cilin poseduesit i lejohet hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në Kosovë deri në nëntëdhjetë (90) ditë nga data në vulë.
- 6.2 Dokumenti i udhëtimit ose prova të tjera të dokumentuara të lejes duhet të tregohen sa herë që personi zyrtar apo polici i UNMIK-ut e kërkon atë gjatë qëndrimit të vizitorit në Kosovë ose me rastin e daljes nga Kosova.
- 6.3 Afati i lejes skadon automatikisht me datën e daljes së vizitorit nga Kosova dhe nenet 3-5 6(1) dhe 6(2) zbatohen përshtatshëmrisht me rastin e çdo kërkesë pasuese për leje nga ana e vizitorit për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm në Kosovë.

## Neni 7

### Vazhdimi i lejes

- 7.1 Poseduesi i lejes për hyrje dhe qëndrim në Kosovë mund të kërkojë vazhdimin e lejes së tij duke bërë kërkesën te personi zyrtar ose polici i autorizuar sipas rregullave në njërin prej stacioneve të caktuara të Policisë së UNMIK-ut. Kërkesa e tillë bëhet së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para skadimit të lejes.
- 7.2 Nenet 3-6 zbatohen përshtatshëmrisht me rastin e kërkimit të vazhdimit të lejes.
- 7.3 Vendimi për vazhdimin e lejes vlen për një periudhë prej nëntëdhjetë (90) ditëve dhe mund të vazhdohet.

## **KREU III: Hyrja dhe dalja nga Kosova**

### Neni 8

#### Obligimet e personave që hyjnë në Kosovë

- 8.1 Personi i cili kërkon të hyjë në Kosovë duhet:

- (a) Të posedojë dokumentin e udhëtimit dhe t'ia tregojë atë personit zyrtar në vendkalimin kufitar;
- (b) Të kontrollohet nga ana e personit zyrtar në vendkalimin kufitar për të vendosur se a mund t'i lejohet hyrja në Kosovë ose nëse i nevojitet leja për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm në Kosovë sipas kësaj Rregulloreje;
- (c) T'i përgjigjet të gjitha pyetjeve duke treguar të vërtetën dhe të paraqesë dokumentet e nevojshme për të vendosur se a mundet personi në fjalë të hyjë dhe qëndrojë në Kosovë si dhe a nevojitet leje për qëllime të tilla.

8.2 Personi zyrtar në vendkalimin kufitar mund të konfiskojë dokumentin e udhëtimit nëse ai ka arsye për të dyshuar se dokumenti në fjalë është i rremë. Personi zyrtar ia lëshon kërkuesit vendimin e arsyetuar me shkrim për një masë të tillë. Vendimi përfshin njoftimin mbi të drejtën për rishqyrtim të vendimit si dhe afatin kohor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim.

#### Neni 9 Hyrja në Kosovë

Personi zyrtar lejon kërkuesin për të hyrë dhe qëndruar në Kosovë kur ai bindet se kërkuesi i tillë:

- (a) I përket kategorive të personave të paraparë në nenin 2.1;
- (b) I përket kategorive të personave të paraparë në nenin 2.2 ose
- (c) I përket kategorive të personave të paraparë në nenin 2.3.

#### Neni 10 Refuzimi i hyrjes në Kosovë

10.1 Personi zyrtar refuzon hyrjen e kërkuesit në Kosovë kur:

- (a) Kërkuesi i tillë nuk është në gjendje që të bindë personin zyrtar lidhur me identitetin e tij ose
- (b) Kërkuesi i tillë nuk i përket kategorive të personave të paraparë në nenet 2.1, 2.2 ose 2.3.

10.2 Pavarësisht nga nenet 9 (b) ose (c), personi zyrtar mund t'ia refuzojë kërkesit, i cili i përket kategorisë së personave të paraparë në nenin 2.2, hyrjen në Kosovë kur personi zyrtar ka arsye për të besuar se një apo më shumë nga kushtet e parapara me nenin 5.2 mund të zbatohen.

10.3 Refuzimi i hyrjes përcaktohet me një vendim të arsyetuar me shkrim i cili do t'i jepet kërkesit të cilit i është refuzuar hyrja. Personi zyrtar ia lëshon kërkesit vendimin e arsyetuar me shkrim për një masë të tillë, i cili përfshin njoftimin mbi të drejtën për rishqyrtim të vendimit si dhe afatin kohor për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim. Vendimi po ashtu përmban urdhrin me të cilin nga kërkesi kërkohet që ta braktisë Kosovën. Policët e UNMIK-ut zbatojnë urdhrin për dëbim të menjëherëshëm nga Kosova.

#### Neni 11 E drejta për të dalur

Të gjithë personat kanë të drejtë daljeje nga Kosova në pajtim me ligjin dhe procedurat mbi kontrollin kufitar me kusht që ta kenë dokumentin e udhëtimit dhe të mos i nënshtrohen ndonjë urdhri ose kufizim lidhur me daljen e tyre nga Kosova sipas ligjit në fuqi.

### **KREU IV: Refugjatët**

#### Neni 12 Kërkesat për statusin e refugjatit

12.1 Personi që kërkon statusin e refugjatit mund të paraqesë kërkesë gojarisht ose me shkrim në një gjuhë sipas zgjidhjes së tij te personi zyrtar apo polici në njërin prej stacioneve të Policisë së UNMIK-ut i cili e përcjellë atë kërkesë te autoriteti kompetent.

12.2 Kërkesa për përcaktimin e statusit të refugjatit mund të dorëzohet:

- (a) Në çdo kohë në qoftë se kërkesi posedon dokumentet e udhëtimit dhe
- (b) Pa vonesë në qoftë se kërkesi nuk i posedon dokumentet e udhëtimit.

12.3 Në qoftë se bëhet kërkesa për statusin e refugjatit, kërkesi do të regjistrohet te

Policia e UNMIK-ut dhe atij i lëshohet leja për t'ia mundësuar qëndrimin e përkohshëm në Kosovë për të pritur vendimin përfundimtar lidhur me kërkesën për statusin e refugjatit.

12.4 Kërkuesi ka të drejtë:

- (a) Të arsyetojë kërkesën e tij personalisht;
- (b) Të gëzojë ndihmën e avokatit sipas zgjedhjes së vet ose t'i sigurohet avokati në qoftë se ai nuk është në gjendje të paguajë ndihmën juridike;
- (c) T'i sigurohet përkthyes pa pagesë;
- (d) Të komunikojë gojarisht ose me shkrim me përfaqësuesin e Komisarariatit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara ("UNHCR") ose të një organizate tjetër kompetente ndërkombëtare;
- (e) Në kontrollim mjekësor sipas kërkesës dhe trajtim mjekësor sa herë që të jetë e domosdoshme dhe;
- (f) Të informohet mbi procedurën për kërkesën e bërë për statusin e refugjatit si dhe mbi të drejtat dhe obligimet e tij gjatë procedurës në gjuhën të cilën ai e kupton.

12.5 Kërkesa për status të refugjatit vendoset në instancën e parë nga ana e autoritetit kompetent.

12.6

Me rastin e marrjes së vendimit, autoriteti kompetent fton kërkuesin dhe avokatin e tij në një seancë për të paraqitur provat. Autoriteti kompetent po ashtu kërkon edhe nga përfaqësuesit e UNHCR-it si dhe nga organizatat tjera kompetente ndërkombëtare që në cilësinë e *amicus curiae* (*miqve të gjyqit*) të vijnë dhe të paraqesin provat. Seancat e tilla mbahen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e kërkesës për status të refugjatit. Gjatë seancës mbahet procesverbali i cili përkthehet në gjuhën e zgjedhur nga kërkuesi dhe nënshkruhet nga kërkuesi.

12.7 Autoriteti kompetent lëshon vendim të arsyetuar me shkrim lidhur me kërkesën brenda shtatë (7) ditëve pas seancës. Vendimi i jepet kërkuesit dhe avokatit të tij si dhe përfaqësuesve të UNHCR-it ose të ndonjë organizate tjetër kompetente ndërkombëtare. Vendimi përfshin njoftimin mbi të drejtën për rishqyrtim si dhe për afatin kohor për të kërkuar rishqyrtimin.

### Neni 13

#### Dhënia e statusit të refugjatit

13.1 Autoriteti kompetent i jep statusin e refugjatit personit atëherë kur ekzistojnë

arsye për të besuar se për shkak të frikës së bazuar nga përndjekja në baza racore, fetare, të shtetësisë, anëtarimit në një grup të caktuar shoqëror ose të mendimit politik:

- (a) Personi gjendet jashtë shtetit të shtetësisë së tij dhe nuk ka mundësi ose për shkak të frikës nuk dëshiron që të shfrytëzojë mbrojtjen e atij vendi ose
- (b) Personi nuk ka shtet në të cilin ka shtetësi, personi gjendet jashtë vendit të tij ku më parë ka pasur qëndrim të përhershëm dhe nuk ka mundësi ose për shkak të frikës nuk dëshiron të kthehet në atë vend.

13.2 Frika e bazuar nga përndjekja ose rreziku nga kanosja e vërtetë mund të jetë e bazuar në ngjarjet që kanë ndodhur që nga largimi i kërkuarit nga vendi amë.

13.3 Autoriteti kompetent i jep statusin e refugjatit fëmijës së varur nën moshën Tetëmbëdhjetëvjeçare (18) ose bashkëshortes së personit të cilit i është dhënë statusi i refugjatit.

#### Neni 14 Refuzimi i statusit të refugjatit

14.1 Autoriteti kompetent refuzon dhënien e statusit të refugjatit për personin kur ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë:

- (a) Ka kryer vepra penale të gjenocidit, të krimit të luftës, krimit kundër njerëzimit ose shkeljeve të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare;
- (b) Ka kryer vepra të rëndë penale jashtë Kosovës para hyrjes në Kosovë ose
- (c) Është konstatuar të ketë kryer vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

14.2 Vendimi mbi refuzimin e statusit të refugjatit përfshin edhe njoftimin mbi të drejtën e rishqyrtimit të tij, afatin kohor për një rishqyrtim të tillë si dhe urdhrin për kërkuarin për të lëshuar Kosovën. Zbatimi i urdhrin për largim nga Kosova pezullohet përkohësisht në pritje të procedurës së rishqyrtimit të vendimit të refuzimit të statusit të refugjatit. Policët e UNMIK-ut zbatojnë urdhrin për largim.

14.3 Autoriteti kompetent i lejon qëndrimin të përkohshëm mbi baza humanitare personit të cilit i është refuzuar statusi i refugjatit në qoftë se personi i tillë ka arsye të bazuar për të qëndruar jashtë shtetit të shtetësisë së tij së paku deri në qartësimin e rrethanave. Mënyra e zbatimit të kompetencës për lejimin e qëndrimit të përkohshëm mbi baza humanitare përcaktohet me urdhëresë administrative.

Neni 15  
Përfundimi i statusit të refugjatit

15.1 Statusi i refugjatit përfundon kur personi:

- (a) Vullnetarisht pranon mbrojtjen e sërishme të shtetit shtetas i të cilit është;
- (b) Sërish e pranon shtetësinë të cilën e kishte humbur më parë;
- (c) Fiton shtetësinë e re dhe gëzon mbrojtjen e vendit të shtetësisë së tij të re;
- (d) Vullnetarisht vendoset në shtetin të cilin e kishte braktisur duke qëndruar jashtë tij për shkak të frikës nga ndjekja;
- (e) Nuk mundet edhe më tutje të refuzojë që të shfrytëzojë mbrojtjen e vendit shtetas i të cilit është meqenëse rrethanat në bazë të të cilave është njohur si refugjat kanë pushuar së ekzistuari ose
- (f) Duke qenë person pa shtetësi, meqenëse rrethanat në bazë të të cilave është njohur si refugjat kanë pushuar së ekzistuari, është në gjendje të kthehet në shtetin e mëparshëm të qëndrimit të tij të përhershëm.

15.2 Autoriteti kompetent vendos për përfundimin e statusit të refugjatit pas kërkesës së personit zyrtar ose sipas detyrës zyrtare. Vendimi për përfundimin e statusit të refugjatit bëhet me shkrim dhe përfshin njoftimin mbi të drejtën për rishqyrtim si dhe afatin kohor për kërkimin e rishqyrtimit. Vendimi po ashtu përfshin urdhrin për largim nga Kosova. Zbatimi i urdhrin për largim nga Kosova pezullohet përkohësisht në pritje të procedurës së rishqyrtimit të vendimit të përfundimit të statusit të refugjatit. Policët e UNMIK-ut e zbatojnë urdhrin për largim.

Neni 16  
Ardhja masive e refugjatëve

Me rastin e ardhjes masive, autoriteti kompetent mund t'u ofrojë mbrojtje të përkohshme personave të cilët vijnë drejtpërsëdrejti nga shteti ku jetra, siguria ose liria e tyre kërcënohet nga lufta, lufta qytetare, okupimi, konflikti i brendshëm i shoqëruar me dhunë ose shkelja masive e të drejtave të njeriut.

Neni 17

## Parimi i mosriatdhesimit

17.1 Asnjë refugjat nuk do të dëbohet e as nuk do të kthehet në asnjë mënyrë te kufijtë e vendeve ku jeta ose liria e tij do të rrezikohet për shkak të racës, fesë, shtetësisë, anëtarimit në ndonjë grup shoqëror ose mendimit të tij politik.

17.2 Refugjati nuk mund të pretendojë që të përfitojë nga paragrafi 1 i këtij neni në qoftë se ekziston dyshim i bazuar për ta konsideruar të rrezikshëm për sigurinë e Kosovës ose i cili është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për një krim veçanërisht të rëndë dhe paraqet rrezik për popullatën e Kosovës.

17.3 Pavarësisht nga nenet 5, 10, 14 dhe 15 personit nuk mund t'i refuzohet hyrja në Kosovë ose të dërgohet në shtetin apo vendin ku ekziston rreziku i vërtetë se ai mund t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit jonjerëzor dhe degradues ose ndëshkimit, dënimit me vdekje apo ekzekutimit ose kërcënimit serioz dhe individual me anë të dhunës pa diskriminim në situatat e konfliktit të armatosur.

17.4 Neni 12 – 15 zbatohet përshtatshëm për zbatimin e mbrojtjes në bazë të nenit 17.3.

## **KREU V: Qëndrimi i përkohshëm në Kosovë**

### Neni 18

#### Qëndrimi i përkohshëm në Kosovë

18.1 Personi zyrtar ose autoriteti kompetent lëshon urdhër për të lejuar personin që të qëndrojë përkohësisht në Kosovë:

- (a) Në pritje të vendimit mbi kërkesën për status të refugjatit;
- (b) Në pritje të vendimit mbi kërkesën për rishqyrtimin e vendimit nga ana e autoritetit kompetent për përfundimin e statusit të refugjatit ose
- (c) Në pritje të vendimit mbi kërkesën për mbrojtje në bazë të nenit 17.3;
- (d) Në pritje të vendimit mbi kërkesën për rishqyrtimin e vendimit të personit zyrtar që ia ka konfiskuar dokumentet e udhëtimit ose
- (e) Në pritje të zbatimit të urdhrit nga neni 5.3 me të cilin kërkohet që personi të lëshojë Kosovën, nëse në mënyrë të veçantë policët e UNMIK-ut nuk mund të zbatojnë urdhrin për lëshim të menjëhershëm të Kosovës.

18.2 Në qoftë se personi në pamje të parë konstaton se ai i plotëson kërkesat e nevojshme për t'u regjistruar si banor i Kosovës, por nuk posedon letërnjoftimin për të dëshmuar se ai është banor i përhershëm i Kosovës, personi zyrtar lëshon urdhër për të lejuar atë që të hyjë dhe qëndrojë përkohësisht në Kosovë në pritje të procedurës së regjistrimit.

18.2 Për urdhrin me të cilin lejohet personi që të qëndrojë përkohësisht në Kosovë, nenet 6 dhe 7 zbatohen përshtatshëm.

## **KREU VI: Masat për të siguruar praninë e personave**

### Neni 19

#### Procedurat për caktimin e masave për të siguruar praninë e personave duke përfshirë edhe arrestimin

19.1 Duke lejuar personin që të qëndrojë përkohësisht në Kosovë në pajtim me nenin 18 personi zyrtar urdhëron që personi i tillë:

- (a) T'ia dorëzojë dokumentin e tij të udhëtimit personit zyrtar në vendkalimin kufitar i cili dokument mbahet deri në largimin e personit nga Kosova nga vendkalimi i tillë kufitar ose
- (b) Të paraqitet në një stacion të Policisë së UNMIK-ut në kohën e caktuar nga personi zyrtar derisa personi i tillë të largohet nga Kosova.

19.2 Në qoftë se të miturit i lejohet qëndrimi i përkohshëm në Kosovë në pajtim me nenin 18, personi zyrtar lëshon njërin nga urdhrat e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni ose personi zyrtar urdhëron që i mituri i tillë:

- (a) Të strehohet te një anëtar i familjes që gjendet në Kosovë ose
- (b) T'i nënshtrohet rregullave të strehimit të caktuara nga ana e autoritetit kompetent të kujdestarisë.

19.3 Duke lejuar personin që të qëndrojë përkohësisht në Kosovë në pajtim me nenin 18, personi zyrtar urdhëron që personi në fjalë të paraburgoset deri në shtatëdhjetë e dy (72) orë në qoftë se ekziston arsye e bazuar se personi i tillë mund të arratiset gjatë qëndrimit të tij të përkohshëm në Kosovë dhe shqipton masat e parapara në nenin 19.1 ose, në rastin e të miturve, neni 19.2 është i pamjaftueshëm për të garantuar praninë e

personit të tillë apo në qoftë se ekzistojnë arsye të bazuara se personi i tillë do të mund të rrezikojë sigurinë në Kosovë ose ai hynë në Kosovë për të minuar qëllimet dhe parimet e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë mbajtjen e rendit dhe ligjet civile, mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të njeriut dhe garantimin e kthimit të sigurt e pa pengesë të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë.

19.4 Para skadimit të paraburgimit të urdhëruar në pajtim me nenin 19.3, kolegji i përbërë prej tre (3) gjykatësve të gjykatës kompetente të qarkut mundet në bazë të kërkesës së personit zyrtar të urdhërojë paraburgimin deri në tridhjetë (30) ditë nga data e paraburgimit, në qoftë se plotësohen kushtet e parapara sipas nenit 19.3. Me rastin e marrjes së vendimit për paraburgim, gjykata fton personin dhe avokatin e tij si dhe personin zyrtar në seancë. Paraburgimi i tillë nuk e tejkalon periudhën kohore të nevojshme për masat e kërkuara sipas nenit 18.

19.5 Në qoftë se personi që ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit me të cilin i është refuzuar statusi i refugjatit është paraburgosur në pajtim me nenin 19.4, kolegji i përbërë prej tre (3) gjykatësve të gjykatës së qarkut, në bazë të kërkesës së personit zyrtar vazhdon paraburgimin e urdhëruar në pajtim me nenin 19.4 për një periudhë maksimale prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nëse plotësohen kushtet e parapara sipas nenit 19.3. Me rastin e marrjes së vendimit për paraburgim, gjykata fton personin dhe avokatin e tij si dhe personin zyrtar në seancë. Paraburgimi i tillë nuk e tejkalon periudhën kohore të nevojshme për marrjen e vendimit në bazë të rishqyrtimit të vendimit. Në qoftë se me rastin e rishqyrtimit kolegji prej tre (3) gjykatësve të gjykatës së qarkut vërteton vendimin për të refuzuar statusin e refugjatit, ai mund të urdhërojë që personi i cili është duke qëndruar përkohësisht në Kosovë të paraburgoset për një periudhë kohore të nevojshme për largimin e tij nga Kosova, nëse plotësohen kushtet e parapara sipas nenit 19.3.

19.6 Kur personi zyrtar lëshon urdhër që personi të largohet nga Kosova sipas nenit 5.3 ose 10.3 në qoftë se ekzistojnë arsye të bazuara se personi në fjalë mund të arratiset, atëherë personi urdhëron që personi në fjalë të paraburgoset deri në shtatëdhjetë e dy (72) orë për të mundësuar kryerjen e përgatitjeve të duhura për të zbatuar urdhrin për largim të menjëherëshëm nga Kosova. Urdhri i tillë për paraburgim nuk mund të vazhdohet.

19.7 Urdhri në pajtim me këtë nen lëshohet me një vendim të arsyetuar me shkrim dhe i dorëzohet personit në fjalë menjëherë.

## Neni 20

### Të drejtat e personave të paraburgosur

20.1 Personi që është urdhëruar të paraburgoset në pajtim me këtë Rregullore do të mbahet në:

(a) Vendin e autorizuar për paraburgim për një kohëzgjatje maksimale prej dymbëdhjetë (12) orëve që nga urdhri i parë për paraburgim dhe

(b) Vendin tjetër të autorizuar për paraburgim pas përfundimit të paraburgimit në vendin e caktuar sipas nenit 20.1 (a).

20.2 Të drejtat e personave të paraburgosur të parapara në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale, Kodin Penal për të Mitur dhe në Rregulloren e UNMIK-ut nr.2004/34 të datës 24 gusht 2004 mbi procedurat penale në lidhje me kryerësit me çrregullime mendore zbatohen përshtatshmërisht ndaj personave të paraburgosur në pajtim me këtë Rregullore.

20.3 Me rastin e paraburgimit personi njoftohet gojarisht dhe me shkrim mbi të drejtat e tij sipas nenit 21 për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit pranë gjykatës kompetente.

#### Neni 21

#### *Habeas Corpus*

21.1 Personi i paraburgosur për një kohëzgjatje më të gjatë se dymbëdhjetë (12) orë në pajtim me këtë Rregullore, ka drejtë që në çdo kohë t'ia paraqesë kërkesën me shkrim trupit gjykues prej tre (3) anëtarëve të gjykatës kompetente të qarkut për të vlerësuar ligjshmërinë e paraburgimit të tij.

21.2 Gjykata cakton seancën e dëgjimit brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas marrjes së kërkesës me shkrim për të vlerësuar ligjshmërinë e paraburgimit në qoftë se përmes kërkesës me shkrim, në shikim të parë, për këtë rast konstatohet se:

(a) Arsyet për paraburgim sipas nenit 19 nuk ekzistojnë më;

(b) Paraburgimi e ka tejkaluar periudhën kohore të lejuar sipas nenit 19 ose

(c) Paraburgimi është i paligjshëm për arsye të tjera.

21.3 Gjykata në seancë dëgjimi e fton personin e paraburgosur apo avokatin e tij dhe zyrtarin i cili e ka urdhëruar paraburgimin apo personin me kërkesë të të cilit është urdhëruar paraburgimi.

21.4 Në seancën e dëgjimit, gjykata menjëherë urdhëron lirimin e personit të mbajtur në paraburgim nëse konstatohet se:

- (a) Arsyet e paraburgimit sipas nenit 19 më nuk ekzistojnë;
- (b) Paraburgimi ka kaluar periudhën e lejueshme sipas nenit 19 ose
- (c) Paraburgimi është i paligjshëm për ndonjë arsye tjetër.

21.5 Gjykata nxjerr vendim të bazuar me shkrim mbi kërkesën e dorëzuar për ligjshmërinë e paraburgimit brenda katërdhjetë e tetë (48) ditëve nga seanca e dëgjimit.

21.6 Vendimet e gjykatës mbi kërkesën e paraqitur me shkrim për ligjshmërinë e paraburgimit janë përfundimtare.

## **KREU VII: RISHQYRTIMI**

### Neni 22

#### Rishqyrtimi i vendimit të zyrtarëve dhe i autoritetit kompetent

22.1 Personi ndaj të cilit është marrë vendim për refuzimin e hyrjes apo lejes për hyrje dhe qëndrim në Kosovë, për mohimin e statusit të refugjatit, për përfundimin e statusit të refugjatit apo për marrjen e dokumenteve të udhëtimit mund t'i paraqesë kërkesë me shkrim panelit prej tre gjykatësve në gjykatën kompetente të qarkut për rishqyrtim të vendimit brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i vendimit ngapersoni i tillë.

22.2 Gjykata mund të rishqyrtojë vendimin e zyrtarit apo të autoritetit kompetent:

- (a) Në bazë të çfarëdo arsye ku përfshihet çështja ligjore apo faktike ose
- (b) Në baza humanitare apo të mëshirës që mbështesin ndryshimin e vendimit.

22.3 Me rastin e rishqyrtimit të vendimit të personit zyrtar, gjykata mund të kërkojë nga përfaqësuesit e UNHCR-it dhe organizatat tjera kompetente ndërkombëtare për të paraqitur prova. Në qoftë se vendimi që duhet rishqyrtuar ka të bëjë me statusin e refugjatit, gjykata cakton seancën publike të dëgjimit brenda dhjetë (10) ditëve pas marrjes së kërkesës për rishqyrtim nga ana e gjykatës për të mundësuar personin zyrtar si dhe kërkuesin ose avokatin e tij që të paraqesin prova.

22.4 Gjykata zgjidhë kërkesën për rishqyrtim duke:

- (a) Anuluar vendimin;

- (b) Ndryshuar vendimin ose
- (c) Vërtetuar vendimin.

22.5 Gjykata lëshon vendim të arsyetuar me shkrim lidhur me kërkesën për rishqyrtim brenda pesë (5) ditëve pas përfundimit të seancës së dëgjimit.

22.6 Vendimi i gjykatës është përfundimtar.

## **KREU VIII: Kundërvajtjet**

### Neni 23 Kundërvajtjet

23.1 Kundërvajtje konsiderohet:

- (a) Dhënia e informatave të rrejshme personit zyrtar gjatë marrjes në pyetje, i vetëdijshëm se informata e tillë është e rrejshme;
- (b) Mosdorëzimi i dokumenteve të kërkuara nga ana e personit zyrtar gjatë marrjes në pyetje;
- (c) Qëndrimi në Kosovë pa lejen e duhur për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm në Kosovë të lëshuar sipas kësaj Rregulloreje ose
- (d) Hyrja a qëndrimi në Kosovë duke përdorur pasaportë fals apo të siguruar në mënyrë kundërligjore, lejen apo ndonjë dokument tjetër që ka të bëjë me hyrjen ose në bazë të mjeteve mashtruese dhe të kundërligjshme a të shtrembërimit të çfarëdo fakti material.

23.2 Kundërvajtjet e parapara në nenin 23.1 janë të dënueshme me:

- (a) Gjobë deri në njëmijë (1.000) euro;
- (b) Dënim maksimal me burg deri në tridhjetë (30) ditë ose në rastin e të miturve me dënim maksimal deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe/ose
- (c) Me urdhër përmes të cilit kërkohet nga personi në fjalë që të largohet nga Kosova për një periudhë prej gjashtë (6) muajve deri në tri (3) vjet.

23.3 Konsiderohet se personi nuk ka kryer kundërvajtje sipas nenit 23.1 në qoftë se kërkon statusin e refugjatit ose është person që mund të ofrojë prova të besueshme se ai është viktimë e trafikimit.

## **KREU IX: Përgjegjësia për shpenzimet e transportit**

### Neni 24

#### Përgjegjësia për shpenzimet e transportit

24.1 Kompania transportuese siguron se personat që i transporton në Kosovë posedojnë dokumentet e rregullta të udhëtimit dhe të identifikimit të kërkuara me këtë Rregullore dhe ligjin në fuqi.

24.2 Kompania transportuese që transporton personat në Kosovë, pas arritjes së secilit mjet transporti në Kosovë prezenton çdo person te personi zyrtar për kontrollim në vendin e caktuar nga ana e personit zyrtar dhe nuk i lejon asnjë personi që të del nga mjete i transportit:

- (a) Në asnjë vend tjetër përveç vendit të caktuar nga personi zyrtar ose
- (b) Derisa të jepet leja nga personi zyrtar.

24.3 Kur personit i lejohet ose nga ai kërkohet që ta braktisë Kosovën në pajtim me këtë Rregullore, personi zyrtar kërkon nga kompania transportuese që e ka transportuar atë person në Kosovë që ta transportojë atë deri në shtetin e fundit nga i cili ka ardhur në Kosovë ose në një shtet tjetër të cilin personi zyrtar e aprovon në bazë të kërkesës së kompanisë transportuese.

24.4 Kur nga personi kërkohet që ta braktisë Kosovën, sepse në momentin e ardhjes në Kosovë nuk ka pasur dokumentin për identifikim apo udhëtim të kërkuar me këtë Rregullore dhe ligjin në fuqi, kompania transportuese që e ka transportuar atë person do të jetë përgjegjëse për të gjitha shpenzimet e transportit të tij deri në shtetin e fundit nga i cili ka ardhur në Kosovë, ose në një shtet tjetër të cilin personi zyrtar e aprovon në bazë të kërkesës së kompanisë transportuese.

24.5 Kur personit i lejohet hyrja në Kosovë ose kur personi në kohën e ardhjes në

Kosovë kishte dokumentin e udhëtimit dhe nga ai kërkohet që në pajtim me këtë Rregullore ta braktisë Kosovën, kurse nga kompania transportuese që e ka transportuar atë në Kosovë kërkohet që ta transportojë atë nga Kosova deri në vendin e fundit të nisjes, atëherë kompania transportuese gëzon të drejtën e kompensimit për shpenzimet e transportit të tij nga Kosova. Mirëpo, kompania transportuese nuk kompensohet për shpenzimet e transportit të personit të tillë nga Kosova në qoftë se ai hyn në Kosovë në cilësinë e anëtarit të ekipit ose për t'u bërë anëtar i ekipit.

24.6 Kur personi hyn në Kosovë si anëtar ose për t'u bërë anëtar i ekipit të automjetit dhe pushon të jetë vizitor, atëherë nga kompania transportuese që e shfrytëzon atë automjet mund të kërkohet që ta transportojë atë deri në shtetin e fundit nga i cili ka ardhë në Kosovë ose në një shtet tjetër të cilin personi zyrtar e aprovon në bazë të kërkesës së kompanisë transportuese. Kompania transportuese do të jetë përgjegjëse për të paguar të gjitha shpenzimet e transportit të atij personi deri në vendin e destinimit.

## **KREU X: Dispozitat përfundimtare**

### Neni 25 Zbatimi

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nxjerr urdhëresa administrative.

### Neni 26 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të.

### Neni 27 Hyrja në fuqi

27.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 maj 2005.

27.2 Periudha kalimtare prej nëntëdhjetë (90) ditëve do të fillojë në datën kur kjo Rregullore hyn në fuqi. Brenda kësaj periudhe prej nëntëdhjetë (90) ditëve, të gjithë personat në Kosovë të cilët në ditën e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi nuk i përkasin asnjërës prej kategorive të personave të paraparë sipas neneve 2.1, 2.2 ose 2.3 duhet të

paraqiten te personi zyrtar ose te polici i autorizuar në stacionin e caktuar të Policisë së UNMIK-ut për të kërkuar lejen e hyrjes dhe të qëndrimit në Kosovë. Personat e tillë të cilët nuk e kanë marrë lejen për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm ose nuk e kanë kërkuar lejen e tillë deri në fund të periudhës prej nëntëdhjetë (90) ditëve konsiderohen se kanë kryer kundërvajtje sipas nenit 23.1 (c).

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm